



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 1033/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Shefqet Damka kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë nga subjekti politik Partia Demokratike Turke Kosovës (KDTP), dega në Prizren paraqitur kundër Komisionit Qëndror Zgjedhor (KQZ), për shkak të publikimit përfundimtar të rezultateve për anëtarë të kuvendit komunal në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

#### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Shefqet Damka kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë në Prizren nga subjekti politik Partia Demokratike e Turke e Kosovës (KDTP).

#### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Shefqet Damka kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë nga KDTP në Prizren në të cilën pretendon se shkak i ankesës të cilës ankohet është numërimi i gabimit të cilën mendon që ka pasur më shumë vota se sa që është numri i regjistruar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

#### **Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-i lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 1033/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Ferit Osmani**



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24( njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.